



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-50 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08- 50 datë 21.02.2025, dhe në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-737/3 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, miratoj:

**AKTVENDIM**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen**  
**e lejes për transmetim në radio**

**NDALET** procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) XHEZ FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr. 08-83 , datë 07.09.2023.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, me Konkluzionin nr.02-657/3 të datës 18.02.2025, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-50 datë 14.02.2025, dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR XHEZ FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-83 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në raportin me shkrim ark.nr.050665/1 datë 14.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në aftin e parashikuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit tp faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio të Agjencisë.

Lidhur me këtë, nga Agjencia me datë 19.02.2025 drejtuar transmetuesit në fjalë është dërguar Shkresë PA1 nr.08-50, datë 19.02.2025, me të cilën njoftohet se nëse nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e



**Agjenci për shërbime  
mediatike audio dhe  
audiovizive**

**rr. Maqedonia nr 3 8  
1000 Shkup  
Republika e  
Maqedonisë së Veriut**

**tel. + 389 2 3103 400**

**[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)**



<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

pranimi të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë vendimin për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 21.02.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-665/2 datë 21.02.2025 se SHTR XHEZ FM SHPKNJP Shkup, më 20.02.2025 ka kryer pagesë në shumë prej 239,814.00 ( dyqind e tridhjetë e nëntë mijë dhe tetëqind e katërmbëdhjetë) denarë, kështu që kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (10 nënparagrafët 1 dhe 10<sup>2</sup> të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr. 08-50 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-50 datë 21.02.2025 dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-737/3 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, vendosi ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuele**  
**Kryetari i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshilla juridike :** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

---

<sup>2</sup> Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).